



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
SEKTORI I ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Nr. 893 prot.

Tiranë, më 25 08 .2025

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 868/5, DATË 14.11.2024 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASI Z. PRENG FRROK PËRKOLA”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga z. Artur Mehmeti nr. 285 prot., datë 07.02.2022, në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur dhe me vendimin nr. 868/5 prot., datë 14.11.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Preng Frrok Përkola”, bazuar në nenin 122 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Lezhë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Gryk Lumi-Tale, Njësia Administrative Shënkoll, Lezhë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Dëshira Pasko**

